



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 5
19.12.2016

NR. VENDIMI 16
05.05.2017

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarë:

Kryesues: BIB NDRECA
Anëtar: ARDIT MUSTAJ
Anëtare: ILIRIANA OLLDASHI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Alma Stafaj, sot më datë 05.05.2017, ora 15:01, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjen me numër regjistri 5/32 që i përket:

PADITËS: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurorja **Doloreza MUSABELLIU**.

(NDAJ) TË PADITUR: **1.G .K, i datëlindjes XXXX, lindur në xxxx dhe banues në xxxxx, i martuar, me shtetësi Shqiptare, përfaqësuar në gjykim nga avokatet A. V. dhe A. P. , në bazë të Prokurës 417 Rep, Nr.112/2, datë 01.02.2017.**

2.XH.K, i datëlindjes XXXX, lindur në xxxxxx dhe banues në xxxxx, me gjendje civile beqar, me shtetësi Shqiptare, përfaqësuar në gjykim nga avokatët A. V. dhe A. P. , në bazë të Prokurës 183 Rep, Nr.77, datë 21.01.2017.

OBJEKTI:1. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit i pasurisë: Pasuria me numër me Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXX, me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë, Vol.X, fq.XXX, tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë) m²,e rregjistruar në emër të shtetasit XH.K.

2.Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet shërbimi përbarimor, ndërsa për administrimin e pasurive Znj.Englantina Osmanlli administratore i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

BAZA LIGJORE:Ligji nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi dëgjoi palët ku:

Prokuroria kërkoi :1. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurisë: Pasuria me numër me Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXXXX, me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë Fikas, Vol.X, fq.XXX, me emrin tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë) m²,e rregjistruar në emër të shtetasit XH.G.K.

2.Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet shërbimi përbarimor, ndërsa për administrimin e pasurive Znj.Englantina Osmanlli administratore i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Përfaqësuesit e palës së paditur kërkuan Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë Për Krime të Rënda Tiranë, me objekt “Konfiskimin e pasurisë nr.XX/XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, me indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë, Fikas, të rregjistruar në vol.X, faq.XXX, me emërtimin tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë)m², në emër të XH.K.

pasi shqyrtoi provat dhe analizoi në tërësi rrethanat e çështjes objekt gjykimi,

VËREN:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka paraqitur në gjykatë kërkesën për konfiskim, kundër XH.K dhe G.K (kërkesë e rregjistruar në Gjykatë me datë 19.12.2016), që të konfiskohej pasuria me: “*numër me Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXXX me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë, Vol.X, fq.XXX, tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë) m²,e rregjistruar në emër të shtetasit XH.K.*”

Gjykata pasi studioi aktet bashkangjitur kërkesës, duke qenë se nga Prokuroria është hetuar dhe pretenduar se pasuria objekt konfiskimi është vënë me kontributin e të paditurit G.K, dhe është rregjistruar në emër po të të paditurit tjetër XH.K (djali i G.K), çmoi se ndër gjyqësia është krijuar drejt, dhe se nuk konstatoi se në këtë gjykim të mund të thirrej me cilësinë e personit tjetër ndonjë subjekt i caktuar, në referim të nenit 22 pika 3 të ligjit nr. 10192 date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit

të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”i ndryshuar, dhe të nenit 193/1 të K.Pr.Civile.

Megjithëse nga ana e Gjykatës, u ndërmorën masa për të bërë të mundur përfundimin e çështjes në një afat sa më të shkurtër, përshak të sjelljes së palëve, mungesës së adresave të sakta për të panditurit (deri sa këta të fundit zgjodhën përfaqësuesit e posaçëm ligjor), dhe nevojës për të kryer ekspertim me ekspert më njohuri në fushën e shkencës dhe teknikës (Ekspertim vlerësues të pasurisë së paluajtshme), gjykimi i kësaj çështje përfundoi në një afat optimal gjykimi, dhe gjithësesi brenda afatit të kondicionuar nga neni 23/2 i Ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009.

Gjykata në bazë të nenit 7/2 të Ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, çmoi se është kompetente për nga pikpamja lëndore dhe tokësore, si dhe nga kompozicioni i saj (Gjykimi me tre gjyqtar).

I. Gjatë hetimit gjyqësor rezultuan rrethanat e mëposhtme.

Me datë 14.06.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin e kësaj date, ka regjistruar procedimi pasuror nr.15 të vitit 2016. Ky rregjistrim është bërë mbi bazën e materjaleve të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut (aktualisht Vendore) Tiranë, me shkresën Nr.1333, datë 15.01.2015, ku ndër të tjera ka vënë në dijeni Prokurorinë mbi arrestimin e shtetasit G.K (fillimisht me qëllim ekstradimi e më pas me qëllim njohjen ndaj tij të një vendimi penal të Gjykatës Milano i dënuar për veprën penale të “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, në disa episode sipas nenit 110 i K.Penal Italian dhe nenit 73 të Ligjit 309/90 për Drogën).

Në kuadër të këtyre veprimeve procedurjale (ku prokuroria e Rrethit Tiranë kishte paraqitur në Gjykata kërkesë për njohje vendimi ndaj G.K), kanë administruar Vendimin Nr.1558/08, i Gjykatës së Apelit Milano, vendimit nr.1232/2007, i Gjykatës (së faktit) Milano, ku sipas të cilit G.K, është dënuar përfundimisht me 16 vite burgim. Gjithashtu ka rezultuar se me datë 25.06.2010, Gjykata e Ksacionit Itali, ka vendosur “Mospranimin e rekursit” të paraqitur nga G.K.

Nga ana e Policisë, fillimisht janë identifikuar tre pasuri që mendohej se disponoheshin nga G.K dhe djali i tij XH.K. Pas verifikimit të bërë nga ana e Prokurorisë, vetëm pasuria me Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXX, me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë, Vol.X, fq.XXX, tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë) m², ka rezultuar e regjistruar në emër të XH.K. Ndërsa dy pasuritë e tjera të referuar nga Policia në Prokurori, rezultuan se ato ishin tjetërsuar kohë me parë tek të tretët.

Ndër të tjera në Vendimin Nr.1558/08, i Gjykatës së Apelit Milano dhe atë nr.1232/2007, i Gjykatës (së faktit) Milano, pasqyrohen rrethanat e faktit, provat që vërtetojnë këto rrethana fakti, episodet në të cilat ka qenë i përfshirë G.K si dhe roli i tij. Sipas vendimeve në fjalë ndër të tjera pasqyrohet se:”...Në bashkëpunim edhe me persona të tjerë me qëllim që të kryente një sëri krimesh të parashikuara nga art74 DPR309/910, trafikimin në sasi të mëdha stuperfacente kryesisht heroinë. Në mënyrë të veçantë K. në pozitën e organizatorit ka drejtuar dhe organizuar nga Shqipëria aktivitetin kriminal që zhvillonte organizata, ka mbajtur raporte me furnizuesitn e drogës, ka

bërë kontratat e blerjes, ka bërë gjithçka të nevojshme që droga të mbërrinte në Itali nga Shqipëria, ka mbajtur kontakte me referentet në Itali. Grupi vepronte në Milano, Shqipëri dhe vende të tjera nga Shtatori 2001 deri në Gusht 2002....”

G.K është gjetur fajtor dhe dënuar me vendim i cili mori formë të prerë përfundimisht me datë 25.06.2010, kur Gjykata e Kasacionit Itali, ka vendosur “Mospranimin e rekursit, për këto episode:..për importimin e 10 kg. heronine me datë 11.09.2001, 16 kg. heroninë datë 20.11.2001, 17 kg. heroninë datë 10.12.2001, dhe 3.5 kg, ku 2 kg. me datë 05.08.2002 dhe 1.5 kg me datë 12.08.2002”.

Ndodhur në kushtet sa më sipër, duke çmuar se G.K është subjekt i ligjit 10192/2009, dhe XH.K është në rrethin e familjarve të afërt të tij (pra edhe ky subjekt i të njëtit ligj), Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, ka marrë informacion dhe ka kryer hetime mbi veprimtarinë ekonomike dhe mënyrën e krijimit të të ardhurave, nëse justifikonin pasurinë e paluajtshme objekt konfiskimi.

II.Provat e paraqitura në gjykim nga palët për të vërtetuar pretendimet e tyre (konformë nenit 12,183,213 e vijues të K.Pr.Civile, dhe Ligjit 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar). Gjatë gjykimit u paraqitën provat sa më poshtë sipas të cilave:

II.1. Provat e paraqitura nga Prokuroria.

-Vendim “Për Regjistrimin e procedimit pasuror” Nr.15, i vitit 2016, të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkëllës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, i datës 14.06.2016”, ku ndër të tjera sipas të cilit sqarohet se Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë me shkresën Nr.1333, datë 15.01.2015, ka referuar materialet për hetim pasuror në ngarkim të shtetasit G.P.K. Nga materjali rezulton se G.K është arrestuar me datë 20.11.2014, për arsye se ndaj tij ekziston një vendim dënimi për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, të dhënë nga Gjykata e Milanos.

Për këtë arsye, bazuar në ligjin Nr.1092, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuaru çmua se ndaj shtetasit G.K dhe rrethit të tij familjar duhet të kryheshin verifikime pasurore. Në këto kushte është urdhëruar rregjistrimi i procedimit pasuror në ngarkim të shtetasve G.K dhe XH.K (përmbajtja e të cilit u citua më sipër tek rrethanat e faktit).

-Shkresa Nr.1333/k, datë 15.01.2015, e Drejtorisë së Qarkut (sot Vendore) të Policisë Tiranë, ku bashkangjitur kësaj shkresë janë materialet referuese për fillimin e procedimit pasuror në ngarkim të shtetasit G.P.K (të cilat kanë përbërë edhe bazën e fillimit të procedimit pasuror).

-Shkresa Nr.532/2, datë 04.03.2015, si kthim përgjigje e shkresë së Prokurorisë Nr.114/1, datë 25.02.2015, me anë të të cilës është dërguar kopje e njëzuar me origjinalin të vendimit Nr.1558/08, i Gjykatës së Apelit Milano, vendimit nr.1232/2007, i Gjykatës (së faktit) Milano, si dhe praktika e arrestimit të shtetasit G. K. në Shqipëri, (ndër të tjera shkurtim vendimi Nr.2753 Akti, datë 21.11.2014, ku është caktuar masa e sigurimit arrest në burg me qëllim ekstradimi, shkurtim vendimi Nr.2753/1 akti, datë 12.12.2014, ku është caktuar masa e sigurimit arrest në burg me qëllim njohjen e vendimit penal të Gjykatës Milano, Urdhër për Ekzekutimin e vendimit etj).

-Organi i Akuzës ju është drejtuar Bankave që ushtrojnë veprimtari të R.Sh, për të dhënat financiare të të paditurve (dhe familjarëve të tjerë të tyre).

Nga përgjigjet e Bankave që operojnë në Republikën e Shqipërisë, nuk kanë rezultuar depozita monetare të të paditurvë në këtë gjykim.

Konkretisht janë kthyer shkresat:

- Shkresa nr.2342/1 prot, datë 28.04.2015, e Bankës Kombëtare Tregtare;
- Shkresa nr.ON-A 6726/2015 prot, datë 17.04.2015, e First Investment Bank;
- Shkresa nr.004756 prot, datë 15.04.2015, NBG Bank;
- Shkresa nr.05741 prot, datë 07.04.2015, e Alpha Bank;
- Shkresa nr.1621/1 prot, datë 09.04.2015, e Bankës së Shqipërisë;
- Shkresa nr.5540 prot, datë 08.04.2015, e Tirana Bank;
- Shkresa nr.15111401 prot, date 08.04.2015, e Intesa San Paolo Bank;
- Shkresa nr.7567/1 prot, datë 09.04.2015, e Veneto Bank;
- Shkresa nr.12041 prot, datë 09.04.2015, e Credins Bank;
- Shkresa nr.3772 prot, datë 10.04.2015,e International Commercial Bank;
- Shkresa nr.15/06985/tbo-002 prot, datë 14.04.2015,e SOCIETE GENERALE

ALBANIA Bank;

- Shkresa nr.8613/1 prot, datë 08.04.2015, e Raiffeisen Bank;
- Shkresa nr.4768/15 prot, datë 17.04.2015,e Banka e Bashkuar e Shqipërisë;
- Shkresa nr.2091/1 prot, datë 17.04.2015, e Union Ban;
- Shkresa nr.4596/2015 prot, datë 08.04.2015, e Bankës së Kreditit të Shqipërisë;
- Nga ana OPGJ, është kërkuar pranë QKL nëse palët e paditura, kanë aplikuar për liçensa, leje dhe autorizime për veprimtari tregtare, ekonomike apo profesionale.

-Në përgjigje të shkresës Nr.23123/k prot, datë 26.11.2014, ndër të tjera QKL, ne shkresën 5914/1, datë 09.12.2014, informon se: pas verifikimit të Rregjistrimit Kombëtar të Liçencave dhe Lejeve, rezulton se përsa i përket listës së personave që është kërkuar (palët e paditura), nuk kanë aplikuar në sportelet e QKL-së, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, personit fizik ose personit të autotizusur për tu paisur me liçencë apo leje.

-Me shkresën Nr.6886/1 Prot, datë 09.12.2014, Agjencia e Legalizimeve, Urbanizimit dhe integritetit të zonave ndërtimore Informale, në përgjigje të shkresës Nr.23121/k, datë 26.11.2014, informon se nga verifikimet e kryera në bazë dixhitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, asnjë nga personat e përmendur në këtë shkresë nuk figurojnë si subjekte aplikues, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimit.

-Sipas procesverbalit mbi kqyrjen dhe marrjen e dokumentave, i datës 22.06.2016, mbajtur nga OPGJ, ku është kqyr faqja zyrtare e QKR, nuk kanë rezultuar të dhëna për shtetasit G.K , E.K dhe XH.K.

-Në përgjigje të shkresës Nr.1554, Prot, datë 23.06.2016, të Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën Nr.10679-4 Prot, fdatë 14.07.2016, Drejtoria e Përgjithshme e shërbimeve të transportit rrugor, sqaron se nga verifikimet e bëra në Arkivën Komëtare Kompjuterike të Mjeteve, rezulton se (informacioni i është kërkuar për shtetasit G.K , E.K , XH.K dhe K.K)-shtetasi XH.G.K , ka në pronësi motorrin me targë XXX. Shtetasit e tjetër nuk kanë automjete të

rregjistruara në DPSHTRR.

-Në përgjigje të shkresës Nr.1597 Prot, datë 24.06.2016 (e Prokurorisë Për Krime të Rënda Tiranë), e Drejtorisë së Përgjithshme e Hetimit Tatimor, me shkresën Nr. 20886 prot, datë 08.07.2016, ka informuar se në sistemin Informatik të Tatimeve për personat G.K, XH.K, E.K dhe K.K, nuk rezulton të kenë ndonjë të dhënë për kryerje të aktivitetit tregtar”.

-Nga ana e Prokurorisë i është drejtuar Zyrës së Pasurive të Paluajtshme, për të verifikuar lidhur me pasuritë X/XXX+X-XX, ndoshtur ne zonën kadastrale XXX, me idneks harte XX X-XX, praktikën e pasurisë Nr.X/XX-XX, ndodhur në zonën kadastrale XXX me indeks harte XX-X-XX, praktikën e pasurisë XX/XX, të ndodhur në zonën kadastrale XXX me indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë XXX (ku sipas të dhënave të organit të akuzës duhet të ishin të rregjistruara në emër të G. dhe XH.K).

-Në bazë të shkresës Nr.26623/2 prot, datë 29.07.2015, Zyra Vendore e Pasurive të paluajtshme Tiranë,ka vënë në dispozicion të Prokurorisë për Krime të Rënda praktikën rregjistruese për pasurinë Nr.XX/XX, të ndodhur në ZkXXX me indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë XXX, të rregjistruar në vol.X, faq.XXX, në emër të XH.K. Bashkangjitur shkresës në fjalë ndër të tjera janë –mandat bankar për taksën e kalimit të pronësisë; Kontratë Shitje Nr.XXXX rep, Nr.XXXX Kol, datë 14.12.2011, e nënshkruar ndërmjet E.S dhe XH.K.

Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, ndër të tjera pasqyrohen (përveç palëve nënshkruese sa më lartë), objekti i saj që është sipërfaqe tokë arë prej 1000 m2, (njëmijë metër katror) ndodhur në XXX Tiranë, e rregjistruar në ZRPP Tiranë me Nr.23/31 volumi X, faqe XXX zk.XXX me kufizimet përkatëse. Çmimi i kësaj pasurie sipas nenit 2 të kontratës, është në shumën prej 1.000.000 lekë, e likujduar jashë zyrës noterjale: Bashkangjitur kontratës është edhe çertifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë Nr.23/31, në emër të shtetasit E.S, rregjistruar me datë 03.02.2011, bashkangjitur kartela e kësaj pasurie dhe harta treguese. Pasuria në fjalë, rezulton se në bazë të kontratës 310 Kol, Nr.41 Rep. datë 19.01.2011, nga ana e shtetasit E.S është blerë nga shtetasit R.K, I.K dhe H.K, në shumën prej 1.000.000 lekë.

-Çertifikatë për vërtetim Pronësie për pasurinë Nr.XX/XX, vol.X, fq.XXX, zk.XXX, në emër të XH.K, rregjistruar me datë 24.12.2011, kartela për këtë pasuri të paluajtshme dhe harta treguese.

-Në përgjigje të shkresës Nr.491 prot. D.M, datë 16.07.2015, Z.V.R.P Tiranë, me shkresën Nr.26623/1, datë 27.07.2015, ndër të tjera ka informuar Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë se: pasuria nr.X/XXX+X-XX, vo.XX,fq.XXX, zk.XXX, është transkriptuar në emër të M.A.D. Kjo pasuri është e rënduar me barrë hipotekore në favor të Intesa Sanpaulo Bank për shumën 50.000 euro. Pasuria nr.X/XXX-X, vol.XX, fq.XX, zk.XXXX, është e transkriptuar në emër të F.P.GJ. Bashkangjitur me këtë shkresë ZRPP dërgon edhe praktikën për këtë pasuri. Në bazë të kontratës XXXX Rep, Nr.XXX Kol, datë 26.05.2005, G.K, ka blerë nga M.GJ (dhe me miratimin e F.P.GJ), pasuri me sipërfaqe prej 56.5m2, (njësi në katin përdhe të një pallati), me nr.pasurie X/XXX-XX, vol.XX, fq.XX, zk.XXXX, me një çmim prej 500.000 mijë lekë, dhe e ka shitur me Kontratë Nr.XXXX Rep, Nr.XXXX Kol, datë 05.02.2006, ne shumën prej 4.000.000

lekë, tek pala blerëse F.P.GJ, ku aktualisht në ZRPP kjo pasuri gjendet e rregjistruar në emër të kësaj shtetase.

-Sipas shkresës Nr.112741/1 Prot, datë 08.07.2016, e Drejtorisë së Përgjithshme të taksave vendore Bashkia Tiranë, është sqaruar se nga verifikimi në terren, rezulton se Zj.F.P.GJ pasurinë në fjalë e ka dhënë me qera subjektit E.H, bashkangjitur edhe kontrata e qirasë lidhur ndërmjet saj dhe shytetasit E.H).

-Në bazë të kontratës Nr.XXXX Rep, Nr.XXX Kol, datë 09.04.2003, G.K ka blerë nga P.K (babai i tij), pasurinë X/XXX+X-XX, vol.X, fq.XXX, zona kadastrale XXX, në shumën prej 1.000.000 lekësh, dhe e ka shitur në bazë të kontratës Nr.XXXX Rep, XXXX Kol, datë 31.05.2012, tek shtetasja M.D, në shumën 80.000 euro.Por sipas deklaratës Noterjale Nr.2908 Rep, Nr.1034 Kol, datë 18.03.2013, G.K dhe E.K, kanë deklaruar se i kanë shitur pasurinë sa më lartë M.D e cila ju ka likjuar shumën prej 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro, dhe kjo e fundit nuk kishte më detyrime financiare ndaj tyre (bashkangjitur janë edhe praktikat rregjistuese në ZRPP).

-Pasuria nr.X/XXX, Apartament në zk.XXX, sipas kontratës Nr.XXXX Rep, XXX Kol, datë 23.11.2000, P.K e ka blerë tek shtetasja F.TH, në shumën prej 1.000.000 lekësh, ku vetë F.TH në bazë të kontratës së shitjes nr.XX/X akti, datë 14.12.1994, e ka blerë këtë pasuri tek shtetasja A.M, në shumën prej 2.200.000.

-Me shkresën 5669/1 prot, datë 17.03.2015, UKT, informon se G.K, nuk ka kontratë të lidhur apo të hapur në emër të tij në këtë subjekt.

-Nga ana e Zyrës Vendore të Pasurive të paluajtshme Elbasan, me shkresën 848/1 Prot, datë 29.06.2016, është kthyer përgjigje se nuk figurojnë të rregjistruara pasuri në emër të të paditurve, duke theksuar se rregjistrimi i pasurive të paluajtshme nuk është informatizuar plotësisht dhe informacioni nuk mund të ishte i plotë për këtë shkak.

-Sipas çertifikatës familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Elbasan, datë 27.06.2016, ndër të tjera rezulton se fëmijët e P.K janë G.K, K.K, F.K etj. Ndërsa sipas printimit elektronik nga rregjistri i Gjendjes civile, rezultin se XH.K është djali i G.K.

II.2.Provat shkresore të Mbrojtjes.

-Kontratë Shit-Blerje automjeti Nr.XXXX Rep, Nr.XXXX Kol, date 27.12.2011, hartuar nga Notere M.Sharka, (kopje e njesuar me akte që ndodhen në dosjen nr.16 Vendimi, datë 23.06.2016 nga K/Sekretari a e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Sipas kontratës në fjalë ndër të tjera pasqyrohet se:*...Shitës XH.K, i datëlindjes XXXXX... dhe blerësi K.T.....duke u bazuar në nenin 705 e vijues të K.Civil, u redaktova këtë kontratë shitje Automjeti e përshkruar Tipi Autoveturë Volksäagen Golf 1 K,...Targa XXXXX, viti 2004, pronësinë e vërteton me çertifikatë pronësie Nr.XXXXXXXXXX 23.02.2011. Këtë automjet shitësat e shesin përkundrejt shumës prej 7000 (shtatë mijë euro), shumë e likjuar totalisht nga ana e blerësit.....”.*

-Deklaratë Noterjale të dhënë para Noterit André Russell Croft (noter publik në

Angli), datë 15.09.2016, ku K.K ka deklaruar për ndihmën që ai ka bërë për nipin e tij XH.K, por duke qenë se ky person u pyet me cilësinë e dëshmitarit dëshmia e tij do të citohet më poshtë.

II.3. Kryerja e ekspertimit, me kërkesë të palëve gjatë gjykimit.

-Akt Ekspertimi Vlerësues (Teknik), i pasurisë të paluajtshme rregjistruar në emër të shtetasit XH.K (i padituri në këtë gjykim), ku ekspertes Vlerësuese Diana Bardhi nga ana e Gjykatës (pasi mori mendimin e palëve), i është kërkuar të bëjë vlerësimin e pasurisë së paluajtshme sipas vlerës së tregut në kohën e transaksionit në emër të shtetasit XH.G.K dhe konkretisht: Pasuria me Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXX me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë, Vol.X, fq.XXX, tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njemije) m².

Në aktin e ekspertimit në fjalë, përshkruhet vendodhja e kësaj prone dhe përshkrimi (për të tepër referoju aktit të ekspertimit pjesë e dosjes). Nga ana e Ekspertes, është bërë përlllogaritja e vlerës së pronës duke u nisur nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në kohën e blerjes së kësaj pasurie, sipas zonës përkatëse duke i shumëzuar me sipërfaqen, ofertat e tregut, standartet e vlerësimit (etj). Kështu vlera e tregut sipas kriterëve të pasqyruar nga ekspertja është 1000 m² x 17000 lekë/m² = 1,700.000 lekë, ku duke e llogaritur sipas kursit të Bankës së Shqipërisë për depozita me afat 12 mujor në vitin 2011, kjo pronë do të kishte si vlerë 978,000 lekë sipas tregut të lirë.

Sipas VKM ne vitin 2008, në zonën XXX Tiranë, kjo pronë ka këtë vlerë 1000 m² x 317 lekë/m² = 317,000 lekë, sipas VKM 89, datë 03.02.2016, “Për Miratimin e hartës së vlerës së tokës në R.Sh”, prona objekt ekspertimit do të ishte viti 2016 1000m² x 448 lekë/m² = 448,000 lekë.

Ndërsa si përgjigje detyrës së lënë nga Gjykata ekspertja, pasi ka përmendur një sërë metodologjisë, bazuar edhe në nenin 3 të VKM 658, datë 26.02.2012, për Miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në R.Sh ekspertja ka theksuar se: *...çmimi i shitjes së pronës, nënkupton shitjen e saj në treg, prandaj referuar çmimit të kontratës së shitjes së pronës në vlerën 1,000.000 lekë mendojmë se ky është dhe çmimi i tregut në kushtet e njohur nga metodologjia e vlerësimit të pronave.*

Dëshmitari K.K.

Për të vërtetuar faktet objekt gjykimi, të paditurit nërmjet përfaqësuesit të tyre, kërkuar që të pyetj me cilësinë e dëshmitarit, K.K. Duke qenë se dëshmitari kishte lidhje familjare (përkatësisht vëllai dhe xhaxha i të paditurve), bazuar në nenin 235 të K.Pr.Civile, ju bë e ditur e drejta për të mos dhënë dëshminë e tij. Dëshmitari u shpreh se jepte pëlqimin për tu pyetur në këtë proces me këtë cilësi.

Dëshmitari dëshmoi se ai kishte shumë kohë që jetonte dhe punonte në Angli, konkretisht në Londër (që nga vitit 1998). Sipas tij, ai e kishte ndihmuar disa herë financiarisht nipin e tij XH.K, duke i dhuruar automjete dhe madje duke i dhënë e edhe paund cash (deri në 2000 dy mijë paund njëherësh). Ai i kishte sjellur disa herë automjete XH, ku një herë kishte qenë një automjet tip Audi A 6. Ai kishte dhënë para nipit ku konkretisht ja kishte sjellur djali i dëshmitarit nga Anglia dhe ja kishte dhënë

XH që me sa i kujtohej të konvertuara kishin qenë rreth 11 milion lekë të vjetra, me të cilat kishte blerë një automjet tip Volksëgen. Këtë automjet e kishte mbajtur rreth 6 muaj nipi i tij dhe më pas e kishte shitur, nuk i kujtohej mirë si kohë por me sa i kujtohetj duhet të ketë qenë viti 2010-2011, koha kur i kishte dhënë paratë.

Duke qenë se XH. kishte rënë në mësimë dëshmitari kishte menduar se kishte qenë ai shkaktari i rënies në mësimë. Sipas tij, ai nipin e kishte ndihmuar edhe herë të tjera, konkretisht duke e marrë me vete në Londër, ku XH. së bashku me bashkëshorten edhe aktualisht e mbante në shtëpinë e tij në Londër. Me XH. ai nuk kishte mbajtur kontratë tek noteri duke qenë se e kishte nip pra për shkak të lidhjeve të afërta familiare.

Gjithashtu dëshmitari dëshmoi (citohet):”...*Dhe e lamë kështu kur të shitet makina do kthente lekët*”.

III. Pretendimet dhe prapsimet e palëve në gjykim (në mënyrë të përmbledhur)

Prokuroria (pala paditëse në rastin në gjykim që përfaqëson interesat e shtetit), si në kërkesën për gjykim ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje (por edhe në konkluzionet përfundimtare), mbajti qëndrimin se: Procedimi Pasuror është rregjistruar mbi bazën e materjaleve të dërguara nga Drejtoria e Qarkut (sot Vendore) e Policisë Tranë me shkresën Nr.1333 prot, datë 15.01.2015, ku është referuar se G.K ishte arrestuar nga autoritetet Shqiptare (fillimisht me qëllim ekstradimi dhe ma pas me qëllim njohje të vendimit penale të Gjykatës Milano, i dënuar për veprën penale të “Trafikimi i narkotikëve” në bashkëpunim për disa episode gjatë vitit 2001-2002. Janë verifikuar pasuritë në emër të G.K (të cilat ishin tjetërsuar vite më parë tek të tretët, duke dhënë kronologjinë për këto pasuri), dhe ka rezultuar vetëm një pasuri në emër të XH.K djali i të paditurit G.

Prokurorja argumenton faktin se këta persona nuk kishin të ardhura të ligjshme që të justifikonin bleren e kësaj pasurie, nuk kishin aktivitet ekonomik dhe se G.K (sqsuar sa më sipër), ishte i përfshirë në aktivitet kriminal disa vite më parë.

Nga ana e Prokurores renditen një sërë veprimesh hetimore.

Argumentohet se G.K dhe XH.K subjekt i ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar.

Argumentohet se pasuriaobjekt konfiskimi hyn në fushë zbatimin e ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar.

Gjithashtu argumentohet se pasuria objekt konfiskimi nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të ardhurave të paditurit në emër të të cilit ishte rregjistruar pasuria objekt konfiskimi.

Evidentohet se këto pasuri i janë nënshtuar sekuestrimit ku Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, me vendimin Nr.10. datë 28.06.2016, ka vendosur sekustrimin e pasurisë sa më sipër, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda Tiranë me vendimin Nr.87, datë 22.09.2016.

Pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë të tij parashtrroi gjatë hetimit gjyqësor dhe në konkluzione përfundimtare këto prapsime:

-Vlera e pasurisë objekt konfiskimi nuk është e tillë që të përbëjë për askënd në Shqipëri në vitin 2011, që të tregojë për përfitim të paligjshëm.

-Duke shfrytëzuar zbatimin me analogi të nenit 13/1 të ligjit 10192/2009lejohet

supërvizim vetëm për pasuritë mbi vlerën mbi dy milion lekë, duk mund të veprojë ligji mbi një vkerë sa gjysma e kufirit minimal për tu konsideruar ligjërisht objekt goditje.

-Gjatë gjykimit u provua se pasuria objekt konfiskimi është blerë me të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit në pronësi të XH.K dhe ndihma e vazhdueshme e dhënë nga xhaxhai i tij K.K. Vlera e shitjes së automjetit, dhe koha përkojnë me vlerën dhe kohën e blerjes së tokës nga ana e XH.

-Dëshmia e dëshmitarit K.K, provoi ndihmën që ai i ka dhënë nipit të tij, por edhe vazhdon akoma ti japë, dhe se pretendimet e Prokurores lidhur më dëshminë e K.K janë absurde.

-Ligji kërkon që koha e veprimit “kriminal” dhe pasurisë së përfutur të jetë relevante. Sipas akteve të dosjes G.K, është përfshirë në aktivitet kriminal në vitin 2001 ndërsa pasurinë XH.K e ka blerë në vitin 2011, dhe nuk ka asnjë lidhje ndërmjet veprimeve të atit me blerjen e kësaj pasurie, pasi XH.K nuk ka asnjë lidhje me të shkuarën e hershme të jatit.

Në këto kushte, përfaqësuesit e palëve të paditura kërkuar rrëzimin e kërkesës së prokurorisë.

IV. Analiza Ligjore.

Në nënin 1 të Ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar përcaktohet se: *Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim.*

Në nënin 2 të po këtij ligji “*Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale*”.

Ndër sa në nënin 3/1 të ligjit në fjalë jepet fusha e zbatimit të këtij ligji ku ndër të tjera sanksionohet se: *Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për: a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre.*

c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.

d) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal....

Në pikën 2 të po këtij neni parashikohet ndër të tjera se: Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të:

a) personave të afërm (bashkëshorti, **fëmijët**, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, unjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehëri, vjehërra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni;..

Në pikën 4:Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes

në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

Në interpretim të dispozitave sa më sipër (por jo vetëm), Gjykata çmon se kërkes-padia e paraqitur nga organi i akuzës për konfiskimin e pasurisë sipas objekti të kërkesës (cituat sa më lartë) përfshihet në fushëzbatimin e këtij ligji.

Pra sipas ligjit, bien në fushëzbatimin e tij, pasuritë e personave për të cilet ka një dyshimi të arsyeshëm bazuar në indicje për pjesëmarrje në një nga veprat e listuara në këtë dispozitë (neni 3/1 të ligjit).

Tek rrethanat e fakti, u pasqyrua se shtetasi G.K, është dënuar për disa episode për veprën penale të “Trafikim i narkotikëve”, në bashkëpunim, nëpërmjet importimit të sasive të mëdha të lëndës narkotike heroine, parashikuar nga neni 110 i K.Penal Italian dhe nenit 73 “Për Drogën”Nr.309/90:G.K është gjetur fajtor dhe dënuar me vendim i cili mori formë të prerë përfundimisht me datë 25.06.2010, kur Gjykata e Kasacionit Itali ka vendosur “Mospranimin e rekursit, për këto episode: *për importimin e 10 kg. heronine me datë 11.09.2001, 16 kg. heroninë datë 20.11.2001, 17 kg. heroninë datë 10.12.2001, dhe 3.5 kg, ku 2 kg. me datë 05.08.2002 dhe 1.5 kg me datë 12.08.2002*, që referuar dispozitave përkatëse të Kodit Penal të R.Sh, këto vepra penale parashikohen nga nenet 283/a/2. (për të mos rënë në përsëritje referoju tek rrethana e faktit).

Në fushëzbatimin e këtij ligji përfshihen edhe pasuritë e: Personave të afërm me personin mbi të cilin rëndon dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrje në një nga veprat e listuara sa më lartë të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji: (bashkëshorti, **fëmijët**, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka (paragrafi 2 pika a).

Në rastin konkret, Gjatë Gjykimit ndër të tjera rezultoi se pasuria objekt konfiskimi është rregjistruar në emër të shtetasis XH.G.K , pra i afërt i subjektit të përfshirë në veprimtarinë kriminale sipas nëni 3 paragrafi 1i argumentuar sa më lartë.

Gjithashtu sipas nenit 3 të ligjit në fjalë, në fushëzbatimin e ligjit (dhe për pasojë subjekte të tij) bien edhe: Pasuritë e personave fizike dhe juridik, kur ka të dhëna të mjaftueshme që zotërohen, qoftë dhe pjesërisht nga personat e dyshuar, në mënyre të drejtëpërdrejte a tërthortë dhe pasuritë e personave fizike dhe juridikë për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se janë përdorur, apo kanë lehtësuar, kane ndikuar në kryerjen e veprimtarive të paligjshme nga personat e dyshuar si pjesëmarrës në listën e veprave penale që gjejne pasyrim në nenin 3.

Gjatë shqyrtimit gjyqësore të kësaj çeshjte, u provua plotësisht se ka dyshime të arsyeshme (madje i padituri G.K përmendur sa më lartë është i të dënuar me vendime të formës së prerë nga autoritetet e huaja, vendime të cilat në rastin konkret janë marrë në formë e kërkuar nga ligjidhe se janë në proces e sipër për njohjen e tyre në Shqipëri, dhe fuqia e tyre provuese nuk vihet në dyshim), të bazuara jo vetëm në indicje por në prova, se ai është i përfshirë në vepimtarin kriminale në disa episode për një nga veprat penale të listuara nga neni 3 paragrafi 1 i (pika ç) të ligjit 10192/2009, dhe se shtetasi XH.K , është subjekt konformë nenit 3/2 si i afërt i këtij personi (është djali i G.K).

Por në interpretim të ligjit sa më sipër, nuk mjafton vetëm që pala e paditur të jetë subjekt i këtij ligji, dhe fushëzbatimi i ligjit, por kondicionohen edhe kushte të tjera që parashikohen shkrehimisht në nenin 24/1 i ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar

Kështu në nenin 24 paragrafi 1 parashkohet shprehimisht:

“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit së të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe

c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit”.

Lidhur me kondicionin (kushtin)e parë (pika (a) e paragrafi 1 e këtij neni u arsyetua sa më lartëse në rastin konkret dyshimet e bazuara janë jo vetëm në indicie, por edhe në prova të pakundërshtueshme, siç janë vendimet e formës së prerë të autoriteteve Gjyqësore të shtetit Italian, për dënimin e të paditurit G.K , duke përcaktuar rrethanat e përfshirjes në këtë veprimtari, shkeljen e dispozitave përkatëse, kohën kur është përfshirë (për të mos rënë në përsëritje referoju tek argumentimi i subjektit dhe rrethanat e faktit).

Përsa i përket pasurisë objekt konfiskimi dhe prejardhjes së saj sipas pikës b) paragrafi 1, neni 24 i ligjit.

Gjykata çmon se për tu konsideruar se të ardhurat e një personi kanë qenë të ligjshme për tu marrë parasysh konformë nennit **24/1/b të ligjit 10192/2009, i ndryshuar**, këto të ardhura duhet të pasqyroheshin nga të dhënat që nxirren nga organet e tatim/taksave, pasuri nga trashëgimia apo aktiviteti ekonomik i evidentuar nga organet kometente, dhurimet me burime të ligjshme, dhe jo çdo “aktivitet i supozuar” pa qenë i formalizuar (në asnjë lloj mënyre), të pretenduar sikur janë nxierrë të ardhura.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çeshtje, palët e paditura në gjykim pretenduan se u paraqiten prova të mjaftueshme se pasuria objekt konfiskimi:me Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXXX, me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Fikas, Tiranë, Vol.X, fq.XXX, tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë) m², është e fituar në mënyrë të ligjshme, ku nga shitja e automjetit tip Autoveturë Volksëgen, me targa XXXXX, për të cilin është nxierrë si e ardhur shuma prej 7000 euro.

Ajo për të cilën gjykata do të argumentojë më poshtë është prejardhja e kësaj pasurie dhe zotërimi i pasurisë që nuk **i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave.**

Gjykata çmon, se vlen të theksohet se pasuria objekt konfiskimi është vënë gjatë dhe pas përfshirjes në veprimtarinë kriminale argumentuar sa më lartë për G.K, dhe se nuk rezulton që as G.K dhe as djali i tij XH.K të kenë ushtruar aktivitet të ligjshëm apo të kenë përfituar të ardhura në ndonjë nga mënyrat e parashikuara me ligj.

Sipas provës shkresore Kontratë Shit-Blerje Automjeti, Nr.XXXX Rep, Nr.XXXX Kol, datë 27.12.2011, lidhur ndërmjet XH.K , dhe K.T , objekt i kësaj kontrate ka qenë shitja e një automjeti Tip Volksëgen, Gof 1K me përshkrimet përkatëse dhe me targa

XXXXX, viti prodhimi 2004. Në përmbajtje të kontratës pasqyrohet se vlera e automjetit është në shumën prej 7.000 (shtet mijë) euro, dhe se kjo shumë ishte e likujdur totalisht nga ana e blerësit.

Përfaqësuesit e palës së paditur pretenduan se kjo shumë ishte përdorur për të blerë pasurinë objekt konfiskimi. Si burim krijimi të kësaj shumë pala mbrojtëse pretendoi se ka shërbyer pikërisht dhënia e një shume prej rreth 1.100.000 lekë (një milion e njëqind mijë lekë) të dhënë nga xhaxhai i të paditurit, konkretisht nga dëshmitari K.K.

Nga përmbajtja e provave shkresore, rezulton se pasuria objekt konfiskimi është vënë pas përfshirjes në veprimtarinë kriminale të të paditurit G.K të cituar sa më lartë, ose të paktën është formalizuar në këtë kohë (kjo pasi vlerat monetare janë përfituar gjatë përfshirjes në veprimtarinë kriminale dhe me pas janë formalizuar duke investuar në pasuri të paluajtshme, në emër të të arfërmve siç është i padituri tjetër XH.K, subjekt i këtij ligji konformë nenit 3/2/a të ligjit 10192/2009, i ndryshuar).

Në zbatim të nenit 3 paragrafi 4 të Ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar, jo vetëm pasuritë e vëna pasi ky ligj ka hyrë në fuqi i nënshtrohet hetimit pasuror, por edhe pasuritë të cilat janë vënë para se ligji të ketë hyrë në fuqi, por me kusht që këto pasuri të jenë vënë gjatë kohës që personi dyshohet të jetë përfshirë në veprimtarinë kriminale, në një nga veprat penale të listuara në nenin 3/1 në një nga pikat e këtij paragrafi.

Në nenin 3 paragrafi 4 sanksionohet shtrehimisht: “ *Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtari kriminale, sipas këtij ligji* “.

Në rastin konkret në gjykim, rezultoi se përfshirja në veprimtarinë kriminale e të paditurit G.K përket me datë të hershem Shtator 2001-Gusht 2002, dhe se pasuria është vënë në këtë periudhë, por që realisht është formalizuar më vonë, çka në këtë rast e gjithë pasuria i nënshtrohet hetimit pasuror në zbatim të këtij ligji.

Vlen të theksohet se fillimisht verifikimet janë nisur për disa pasuri që dyshoheshin se disponoheshin nga i padituri G.K. Ajo që vihet re është se i padituri ka bërë disa transaksione që për Gjykatën janë të dyshimta si përsa i përket vlerës sëshit-blerjes, ashtu edhe personave me të cilët ka bërë transaksione.

Si shembull është pasuria Nr.X/XXX-XX, vol.XX, faqe XX ZKXXXX, me sipërfaqe 56.5m², ku në bazë të kontratës Nr.XXXX Rep, Nr.XXX Kol, datë 26.05.2005, është e lidhur ndërmjet dhëndërrit të të paditurit (M.GJ, dhe të të paditurit G.K, dhe pëlqimin për këtë shitje e ka dhënë edhe bashkëshortja e M. , F.P.GJ , e datëlindjes XX.XX.XXXX.

Sipas certifikës familjare të datës 27.06.2016, lëshuar nga ZGJC Elbasan, rezulton se F.K, e bija e P, e datëlindjes XX.XX.XXXX, është motra e G.K, dhe sipas kontratës është bashkëshortja e M.GJ. Ajo që e bën akoma më të dyshimtë këtë moment, është se e njëjta pasuri pas rreth një viti shitet nga ana e G.K tek motra e tij tashmë F.P.GJ, në shumën prej 4.000.000 (katërmilion) lekë (ku ishte blerë në shumën prej 500.000 lekë).

Gjithashtu për gjykatën rezultojnë në transaksione të dyshimta edhe për pasurinë Nr.X/XXX+X-XX, vol.X, fq.XXX, ZK.XXXX, ku transaksioni është bërë me babain e tij, për një

shumë prej 1.000.000 (një milion lekësh), ku babai i tij, P.K, e kishte blerë këtë pasuri tek shtetasja F.TH në po këtë shumë. Ndërsa kjo e fundit e kishte blerë në vitin 1994 në shumën prej 2.200.000 (dymilion e dyqind mijë lekë). Ndërkohë që më pas G.K e shet po këtë pasuri në shumën prej 80.000.(tetëdhjetë mijë) euro sipas kontratës së shitblerjes (për më tepër referoju tek provat shkresore sa më sipër). Më vonë deklaroi se blerësja i kishte likuajduar shumën prej 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro dhe se ishte likuajduar metë.

Të gjitha veprimet e mësipërme për Gjykatën janë të dyshimta, por duke qenë se nuk janë objekt konfiskimi, Gjykata do të argumentojë dhe do të fokusohet tek pasuria objekt konfiskimi dhe tek zotëruesi i vërtetë e saj.

Duke qenë se u provua sa më sipër, bazuar në nenin 21/3 e ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.

Përsa i përket barrës së provës se pasuria është vënë në mënyrë të ligjshme, pala e paditur nuk provoi se pasurinë e ka vënë në mënyrë të ligjshme në kushtet kur siç u argumentua me sipër ata janë subjekti i Ligjit.

Gjykata çmon se organi i akuzës gjatë gjykimit, ka paraqitur prova se pasuria e të paditurit nuk është vënë në mënyrë të ligjshme, ndërsa pala e paditur nuk paraqiti prova për të vërtetuar ligjshmërinë e pasurisë së tij, ose provat me të cilat kërkoi të provonte një pretendim të tillë, nuk kanë vlerën e të provuarit të fakteve të pretenduara.

Nisur nga tërësia e provave shkresore me fuqi të plotë provuese, dhe të transkriptuara në rregjistrat Publik (pasqyruar edhe në aktin e ekspertimit Vlerësues të pasurive të paluajtshme), provohet se: pasuria Nr.XX/XX, e ndodhur në z.k,XXX, me indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë Fikas, e rregjistruar në vol.X faq.XXX, është në emër të XH.K. Kjo pasuri është blerë me Kontratë shitje Nr.XXXX rep, Nr.XXXX Kol, datë 14.12.2011, e nënshkruar ndërmjet E.S dhe XH.K, çmimi i kësaj pasurie sipas nenit 2 të kontratës është në shumën prej 1.000.000 lekë, e likuajduar jashë zyrës noterjale. Ky rregjistrim është transkriptuar me datë 24.12.2011, në rregjistrin hipotekor, në emër të shtetasit XH.K.

Kjo pasuri ka qenë e rregjistruar në emër të shtetasit E.S, me 03.02.2011, ku ky i fundit e ka blerë këtë pasuri në bazë të kontratës Nr.310 Kol, Nr.41 Rep. datë 19.01.2011, nga shtetasit R.K, I.K dhe H.K, në shumën prej 1.000.000 lekë.

Gjykata çmon se nisur nga përmbajtja e kontratave të shit-blerjes cituar sa më lartë (të lidhura brenda të njëtit vit dhe në të njëjtën vlerë) dhe aktit të ekspertimit, vlera e tregut e pasurisë objekt konfiskimi, është 1.000.000 (një milion) lekë sa kanë pasqyruar palët në kontratë.

Lidhur me pretendimin se pasuria objekt konflikti, është krijuar me burime të ligjshme, duke pretenduar se nga shitja e automjetit tip Volksäagen me targa XXXX, janë përftuar 7000 (shtatë mijë euro), dhe se këto para janë përdorur pikërisht për blerjen e kësaj pasurie Gjykata çmon se pala e paditur nuk e provoi një pretendim të tillë pra lidhur me ligjshërinë e këtyre të ardhurave dhe për pasojë duke mbetur i pa provuar duhet rrëzuar.

Duke u nisur nga data e nënshkrimit të kontratës së blerjes së pasurisë Nr.XX/XX,

rezulton se ky transaksion është bërë me datë 14.12.2011, ndërkohë që automjeti është shitur me datë 27.12.2011, pra disa ditë pasi ai e kishte blerë tashmë atë pasuri dhe sipas përmbajtjes së kontratës vlera e asaj pasurie (tokës) ishte likujduar tërësisht (pra para momentit të nënshkrimit të saj).

Edhe sikur për një moment të pranohet pretendimi i palës së paditur se pikërisht kanë shërbyer paratë e shitjes së këtij automjeti për të blerë pasurinë e paluajtshme objekt konfiskimi, përsëri pala e paditur nuk justifikon burimin e krijimit të kësaj pasurie, pra të ardhurat për blerjen e automjetit që e shiti më pas për të blerë pasutrinë e paluajtshme.

Pala e paditur pretendoi se këtë pasuri, pra automjetin e ka blerë me paratë që i kishte dhënë xhaxhxi i tij, dëshmitari K.K.

Gjykata çmon se dëshmia e dëshmitarit K.K është kontradiktore dhe për më tepër e pabesueshme në vetë-vete dhe e pa konfirmuar nga asnjë provë tjetër. Kështu ai dëshmoi se rreth vitit 2010-2011, i kishte dhënë nipit të tij, një shumë në para që e konvertuar ishte rreth 1.100.000 (njëmilion e njëqind mijë) lekë. Nipin e tij e kishte ndihmuar disa herë, ku një herë i kishte sjellur një automjet Audi A6, dhe XH. e kishte shitur për vete. Ndërsa automjetin Volksäagen e kishte blerë në Durrës, me paratë që i kishte dërguar vetë dëshmitari nëpërmjet djalit të tij. Po kështu bie në kontraditë edhe pjesa e dëshmisë ku ai thotë që *“Dhe e lamë kështu kur të shitet makina do kthente lekët”*, pra paratë shkuan për blerjen e tokës apo janë kthyer dëshmitarit.

Pala e paditur nuk paraqiti asnjë provë që ta bënte të besueshme dëshminë e dëshmitarit, ku p.sh, mund të paraqiste kontratën e dhurimit të Audit A6, apo edhe shitjen e këtij automjeti në emër të XH.K, nuk paraqiti të ardhurat e dëshmirarit si bustapagat, apo tërheqjet bankare të kohës që pretendon tja ketë dhënë këto para nipit të tij për berjen e automjetit, apo ndonjë provë tjetër që ta bënte tëbesueshme dëshminë e tij.

Përsa i përket deklaratës noterjale të hartuar nga Noteri Publik në Londër, e datës 15.09.2016, gjykata çmon se nga pikpamja e përmbajtjes kjo deklaratë nuk ka vlerën e të provuarit për faktet që pretendohet. Kjo pasi K.K për këto fakte u pyet në gjykatë me cilësinë e dëshmitarit, vlera e dëshmisë së tij u citua më sipër. Pra nuk provohet se paratë për blerjen e automjetit në fjalë janë dhënë nga dëshmitari K.K.

Vetë XH.K, nuk rezulton të ketë qenë në punë, në vitin 2011 ka qenë 20 vjeç, dhe pa të ardhura të ligjshme të evidentuara në ndonjë institucion.

Pas shqyrtimit të një sërë provash të cituara edhe më sipër, ku organi i akuzës i është drejtuar të gjitha institucionve të cilat mund të kenë të dhëna për pasuritë e të paditurit XH.K, nuk rezulton që ai të ketë zotëruar pasuri të tjera apo aktivitet ekonomik.

Gjykata çmon se plotësohet edhe kushti i parashikuar nga neni 24/1/c, ku defacto vlerat monetare për blerjen dhe vënien e pasurisë objekt konfiskimi është realizuar nga i padituri G.K, dhe se zotërues deiuro është djali i tij XH.K.

V.Lidhur me pretendimet e palëve.

Pala e paditur pretendoi se duke u nisur nga vlera e vogël e pasurisë nuk mund të përbëjë objekt paligjshmërie për askënd në vitin 2011, në rrethat në R.Sh. Gjykata çmon se ky pretendim e palës së paditur nuk qëndron. Vetë ligji ka përcaktuar disa rregulla detyruese,

si subjektet, pasuria që bien në fushëzbatimin e këtij ligji etj, ku këto kritere u sqaruar hollësisht më lartë. Ligji nuk përfshin çdo individ apo çdo pasuri në fushëzbatimin e tij, por personat që janë përfshirë në veprimtarinë kriminale dhe të afërmit e tyre, dhe pasuria që nuk justifikohet nga burime të ligjshme.

Lidhur me pretendimin e zbatimit të nenit 13/1 të ligjit edhe në rastin konkret, ligji i referohet në rastet e revokimit të sekuestros, dhe në asnjë dispozitë nuk ka vënë dysheme apo tavan të pasurisë së përfituar nga veprimtaria kriminale për veprat e përmenduar në këtë ligj.

Përsa i përket burimit të krijimit të të ardhurave nga XH.K, dhe vlerës së dëshmisë së K.K, gjykata e argumentoi sa më lartë këtë pretendim.

Lidhur me pretendimin që G.K, është përfshirë në veprimtari kriminale në vitin 2001 ndërsa XH e ka blerë këtë pasuri në vitin 2011, vetë ligji ka parashikuar kohë veprimin e tij, i cili vepron jo vetëm mbi pasuritë e vënapas hyrjes së ligjit në fuqi, por edhe më përpara me kusht që pasuria të jetë vënë gjatë përfshirjes në veprimtarinë kriminale. Gjykata çmon se edhe këtij pretendimi ju dha përgjigje në argumentat sa më sipër dhe në tërësi në këtë vendim.

Pala e paditur kishte detyrimin ligjor në zbatim të nenit 21e vijues të ligjit, të provonte prejardhjen e ligjshme të kësaj pasurie.

Vetë ligjvënësi sipas këtij ligji, ka ceduar në disa parime juridike civile dhe penale duke u nisur nga interesi publik, ku i ka kaluar barrën e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, dhe që i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi (neni 21/3 i ligjit 10192/2009). Kjo duke u bazuar edhe në aktet Ndërkombëtare siç është “KONVENTA MBI PASTRIMIN, DEPISTIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TE KRIMIT, Strasburg, 8.XI.1990, ratifikuar me Ligj nr.8646, datë 20.7.2000”, apo akte të tjera ndërkombëtare në fushën e Krimin të Organizuar.

VI. Shpenzimet procedurjale.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, ku ekspertimi vlerësuese është në shumën prej 40.000 (dyzet mijë lekë), sipas faturës tatimore të shitjes bashkangjitur aktit të ekspertimit, shpenzimeve hetimore të hetimot pasuror, shpenzimet gjyqësore sipas formularit bashkangjitur, parapaguar nga shteti, i ngarkohen të paditurve në mënyrë sollidare. Kjo në zbatim të nenit nenit 25 pika 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

VII. Ekzekutimi i vendimit dhe administrimi i pasurive objekt konfiskimi.

Gjykata çmon se është i bazuar edhe kërkimi i Prokurorisë përsa i përket institucioneve të ekzekutimit të vendimit dhe administrimit. Në këto kushte, për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Përmbartimore Tiranë dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori Eglantina Osmanlli (sipas kërkesës së Prokurorit).

Përsa i përket të drejtës së ankimit kundër vendimit për konfiskimin e pasurisë, në nenin 27 pika 2, të ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, është parashikuar e drejta e ankimit sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedures Civile, dhe se ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Ankimi në Gjykatën e Apelit sipas K.Pr.Civile, parashikohet në nenin 443/2 të tij, i

cili është 15 ditë, dhe duke qenë se ligji nuk parashikon ndryshe, gjykata çmon se edhe në rastin konkret vlen ky rregull për ankimin.

Në nenin 12/5 (fjalë e dytë) të Ligjit 10192 date 03.12.2009, i ndryshuar parashikohet në rast të kërkesës për konfiskim masa e sekuestrimit vazhdon deri në përfundimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë, ndërsa në nenin 28/1 parashikohet se vendimi i konfiskimit të pasurive vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së tij.

PËR KËTO ARSYE.

Gjykata, bazuar nënenet 3, 7/2,12/5 21-28, të ligjit Nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”i ndryshuar, nënenet 126, 306 – 310 të K.Pr.Civile,

VENDOSI

1. Pranimin e padisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurisë së paluajtshme :Nr.XX/XX, Zona Kadastrale XXX, me Indeks harte X-XX-XXX-(XX-X), Tiranë Fikas, Vol.X, fq.XXX, e emërtuar tokë arë, me sipërfaqe 1000 (njëmijë) m², rregjistruar në emër të XH.K.
- 3.Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Përbarimore Tiranë dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori pranë këtij institucioni, Eglantina Osmanli.
4. Urdhërohet kryesekretaria pranë kësaj gjykate, qet'i komunikojë një kopje të këtij vendimi Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, si dhe Zyrës së Përbarimit Gjyqësor Tiranë.
5. Shpenzimet hetimore të hetimit pasuror, shpenzimet gjyqësore (sipas formularit përkatës), përshirë dhe shpenzimet për ekspertime kryer gjatë gjykimit në masën 40.000 lekë (dyzet mijë) lekë, të parapaguara nga shteti, ju ngarkohen të paditurve në mënyrë solidarë.
- 6.Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ankim i cili nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 05.05.2017.

SEKRETARE
Alma STAJAJ

GJYQTAR
BIB NDRECA

